

# PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT EKONOMIKE, SHOQËRORE DHE KULTURORE

*Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966*

HYRË NË FUQI: më 3 janar 1976,

në përputhje me nenin 27

## HYRJE

*Shtetet palë të këtij Pakti,*

*Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,*

*Duke njohur se këto të drejta burojnë nga dinjiteti i lindur i njeriut,*

*Duke njohur se, në përputhje me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, ideali i njerëzve të lirë që gëzojnë lirinë nga frika dhe skamja, mund të realizohet vetëm në qoftë se janë krijuar kushtet të cilat i lejojnë secilit të gëzojë të drejtat e tij ekonomike, shoqërore e kulturore, si dhe të drejtat e tij civile dhe politike,*

*Duke pasur parasysh se Karta e Kombeve të Bashkuara u ngarkon shteteve si detyrë për të nxitur respektimin universal dhe efektiv të të drejtave dhe të lirive të njeriut,*

*Duke kuptuar faktin se individi ka detyra ndaj të tjerëve dhe ndaj kolektivitetit të cilit i përket dhe se ai është përgjegjës për t'i nxitur dhe respektuar të drejtat e njohura në këtë Pakt,*

*U morën vesh për nenet e mëposhtme:*

## **PJESA E PARË**

### **Neni 1**

1. Të gjithë popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes. Në bazë të kësaj të drejte, ata përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe ndjekin lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

2. Për të arritur qëllimet e tyre, të gjithë popujt mund t'i disponojnë lirisht pasuritë dhe burimet e tyre natyrore, pa cenuar kurrfarë detyrimesh që rrjedhin nga bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar, që bazohet në parimin e përfitimit të ndërsjellë, dhe nga e drejta ndërkombëtare. Një popull nuk mund të privohet nga mjetet e veta të jetesës në asnjë rast.

3. Shtetet palë të këtij Pakti, duke përfshirë edhe ato që janë përgjegjëse për administrimin e territoreve jovetëqeverisëse dhe të territoreve nën kujdestari, ndihmojnë realizimin e së drejtës së popujve për vetëvendosje dhe respektojnë këtë të drejtë, në përputhje me dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

## **PJESA E DYTË**

### **Neni 2**

1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të veprojë, si në mënyrë të vetvetishme ashtu edhe nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, sidomos atë ekonomik e teknik, deri në maksimumin e burimeve të veta në dispozicion, për të siguruar progresivisht ushtrimin e plotë të të drejtave të njohura në këtë Pakt me të gjitha mjetet e përshtatshme, duke përfshirë sidomos miratimin e masave legjislative.

2. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të garantojnë që të drejtat e shpallura në këtë Pakt, të ushtrohen pa kurrfarë diskriminimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare a shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.

3. Vendet në zhvillim, duke pasur parasysh, ashtu si duhet, të drejtat e njeriut dhe ekonominë e vet kombëtare, mund të përcaktojnë së në ç'masë do t'i garantojnë të drejtat ekonomike të njohura në këtë Pakt për ata persona të cilët nuk janë shtetas të tyre.

### **Neni 3**

Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas për t'i gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore të përmendura në këtë Pakt.

### **Neni 4**

Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se, në gëzimin e atyre të drejtave të siguruara nga shteti në përputhje me këtë Pakt, shteti mund t'ua nënshtrojë këto të drejta vetëm kufizimeve të parashikuara me ligj në masën që është në përputhje me natyrën e këtyre të drejtave dhe vetëm me qëllim të përparimit të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.

### **Neni 5**

1. Asgjë në këtë Pakt nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të ndërmarrë ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim duke pasur për qëllim zhdukjen e të drejtave dhe të lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizime më të gjëra se sa ato të parashikuara në këtë Pakt.

2. Nuk do të pranohet asnjë kufizim ose shkelje e të drejtave themelore të njeriut që janë të njohura ose që ekzistojnë në fuqi në çdo vend në bazë të ligjeve, konventave, rregulloreve ose zakoneve, me pretekstin se ky Pakt nuk i njeh ato ose i njeh në një shkallë më të vogël.

## **PJESA E TRETË**

### **Neni 6**

1. Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e punës e cila përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrin masa të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë.

2. Hapat të cilat çdo shtet palë i këtij Pakti do t'i marrë për arritjen e realizimit të plotë të kësaj të drejte do të përfshijnë drejtimin tekniko-profesional, programet e aftësimi, të politikave dhe të teknikave për të arritur zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e kulturor dhe punësim të plotë e produktiv, sipas kushteve të cilat u garantojnë individëve gëzimin e lirive themelore politike dhe ekonomike.

## Neni 7

Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për të gëzuar kushte pune të drejta e të favorshme të cilat sigurojnë sidomos:

- (a) Shpërblim të atillë që, si minimum, u siguron të gjithë punonjësve;
  - i) Paga të drejta dhe shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë, pa kurrfarë dallimi; në veçanti, grave duhet t'u garantohen kushte të punës të cilat nuk janë më të këqija se ato që i gëzojnë burrat dhe të marrin shpërblim të njëjtë si burrat për një punë të njëjtë;
  - ii) Jetë të denjë për vete dhe për familjet e tyre në përputhje me dispozitat e këtij Pakti;
- (b) Kushte të sigurta dhe higjienike të punës;
- (c) Mundësi të njëjtë për secilin për t'u ngritur në një kategori të përshtatshme më të lartë, në punën e tyre, duke marrë parasysh vetëm kohëzgjatjen e shërbimeve të kryera dhe aftësinë,
- (ç) Pushim, kohë të lirë, kufizim të arsyeshëm të kohës së punës dhe pushime periodike të paguara, si dhe shpërblimin për ditët e festave.

## Neni 8

1. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen se do të sigurojnë:

- (a) Të drejtën e secilit për të formuar sindikata ose për t'u bashkuar me sindikatën që ka zgjedhur, varësisht vetëm nga rregullat e organizatës së interesuar, për përparimin dhe mbrojtjen e interesave të veta ekonomike e shoqërore. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i kufizimeve që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar ose të rendit publik, ose për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve;
- (b) Të drejtën e sindikatave për të formuar federata ose konfederata kombëtare dhe të drejtën e këtyre të fundit për të formuar organizata sindikale ndërkombëtare ose për t'u bashkuar në to.
- (c) Të drejtën e sindikatave për të funksionuar lirisht, pa kurrfarë kufizimesh të tjera me përjashtim të atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme, në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar ose të rendit publik, ose për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve;

(ç) Të drejtën e grevës, me kusht që kjo e drejtë të ushtrohet në përputhje me ligjet e çdo vendi të veçantë.

2. Ky nen nuk parandalon caktimin e kufizimeve ligjore, për ushtrimin e këtyre të drejtave nga pjesëtarët e forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

3. Asgjë në këtë nen nuk autorizon shtetet palë të Konventës së vitit 1948 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, që ka të bëjë me lirinë sindikale dhe me mbrojtjen e së drejtës sindikale, për të marrë masa legjislative të cilat do të shkelnin ose zbatonin ligjin sipas mënyrës që do t'i cenonte garancitë e parashikuara në atë Konventë.

## **Neni 9**

Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për sigurinë shoqërore, duke përfshirë edhe sigurimin social.

## **Neni 10**

Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se:

1. Një mbrojtje dhe ndihmë sa më e gjerë duhet t'i jepen familjes, e cila është element i natyrshëm dhe themelor i shoqërisë, sidomos për formimin e saj dhe për atë kohë sa ajo ka përgjegjësinë për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve në ngarkim. Martesa duhet të bëhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve të ardhshëm.

2. Mbrojtje e veçantë duhet t'u jepet nënave gjatë një periudhe të arsyeshme kohore para dhe pas lindjes së fëmijëve. Nënave të punësuar, gjatë kësaj periudhe, duhet t'u jepen pushime të paguara ose pushime të shoqëruara me shpërblime të përshtatshme nga ana e sigurimeve sociale.

3. Masa të posaçme të mbrojtjes dhe ndihmës duhet të merren në të mirë të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve, pa kurrfarë diskriminimi për shkaqe birësie ose për shkaqe të tjera. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të mbrohen kundër shfrytëzimit ekonomik e shoqëror. Punësimi i tyre në punët e dëmshme për moralin ose shëndetin e tyre, të rrezikshme për jetën ose të dëmshme për zhvillimin e tyre normal duhet dënuar me ligj. Shtetet duhet gjithashtu të caktojnë afate moshe nën të cilat do të ndalohej dhe do të dënohej me ligj shfrytëzimi me pagesë i fuqisë punëtore të moshës fëmijërore.

## **Neni 11**

1. Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për një standard adekuat të jetesës për vete dhe për familjen e tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin adekuat si

dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. Shtetet palë do të marrin masa të përshtatshme për të siguruar realizimin e kësaj të drejte, duke njohur për këtë qëllim rëndësinë thelbësore të një bashkëpunimi ndërkombëtar të pranuar lirisht.

2. Shtetet palë të këtij Pakti, duke njohur të drejtën themelore të secilit për të qenë i mbrojtur nga uria, do të marrin masa individualisht, dhe nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë programe të veçanta të nevojshme:

(a) Për të përmirësuar metodat e prodhimit, të ruajtjes dhe të shpërndarjes së ushqimeve duke përdorur plotësisht njohuritë teknike dhe shkencore, duke përhapur parimet e edukatës ushqimore dhe duke zhvilluar ose reformuar sistemet agrare asisoj për t'u arritur një zhvillim dhe shfrytëzim sa më efektiv i burimeve natyrore;

(b) Për të siguruar një ndarje të drejtë të pasurive ushqimore botërore në raport me nevojat duke marrë parasysh problemet që shtrohen si përpara vendeve importuese ashtu edhe përpara vendeve eksportuese të artikujve ushqimorë.

## **Neni 12**

1. Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për të pasur gjendje sa më të mirë shëndetësore, fizike e mendore që ai është i aftë të arrijë.

2. Masat që shtetet palë të këtij Pakti do t'i marrin për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte duhet t'i përfshijnë ato masa që janë të nevojshme për të siguruar:

(a) Uljen e vdekshmërisë gjatë lindjes dhe vdekshmërisë së foshnjave, si dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës;

(b) Përmirësimin e të gjitha aspekteve të higjienës së mjedisit dhe të higjienës industriale;

(c) Parandalimin, mjekimin dhe kontrollin e sëmundjeve epidemike, endemike, profesionale dhe të sëmundjeve të tjera;

(ç) Krijimin e kushteve të cilat do të siguronin shërbime mjekësore dhe ndihmë mjekësore për të gjithë në rast sëmundjeje.

## **Neni 13**

1. Shtetet palë të këtij Pakti, njohin të drejtën e secilit për arsim. Ato pajtohen se arsimi duhet të orientohet drejt zhvillimit të plotë të personalitetit njerëzor dhe të ndjenjes së dinjitetit të tij dhe të forcojë respektin për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ato pastaj pajtohen se arsimi duhet t'i mundësojë secilit për të marrë pjesë në mënyrë efektive

në një shoqëri të lirë, të ndihmojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjitha kombeve dhe të gjitha grupeve racore, etnike ose fetare dhe zhvillimin e veprimtarive të Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

2. Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte:

(a) Arsimi fillor duhet të jetë i detyrueshëm dhe falas për të gjithë.

(b) Arsimi i mesëm, në format e tij të ndryshme, duke përfshirë arsimin e mesëm teknik dhe profesional, duhet të jetë i përgjithshëm dhe i hapur për të gjithë me të gjitha mjetet e përshtatshme sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimin falas;

(c) Arsimi i lartë duhet të bëhet i hapur për të gjithë në mënyrë të barabartë sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme e sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimin falas;

(ç) Arsimi themelor duhet të inkurajohet ose të intensifikohet, mundësisht sa më shumë, për ata persona të cilët nuk kanë pasur ose nuk kanë përfunduar plotësisht tërë periudhën e arsimit të tyre fillor;

(d) Duhet të vazhdohet aktivisht zhvillimi i një rrjeti shkollor në të gjitha shkallët, të vendoset një sistem i përshtatshëm bursash dhe të përmirësohen vazhdimisht kushtet materiale të personelit mësimor.

3. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, po qe se është e nevojshme, të kujdestarëve ligjorë, për të zgjedhur për fëmijët e vet shkollat, përveç atyre që i kanë themeluar autoritetet publike, por që të jenë në përputhje me normat minimale që mund të jenë caktuar ose miratuar nga shteti në fushën e arsimit, dhe për të siguruar arsimimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.

4. Asnjë pjesë e këtij neni nuk duhet të interpretohet si ndërhyrje në lirinë e individëve dhe të personave juridikë për të krijuar dhe drejtuar institucione arsimore, por gjithnjë me kusht që parimet e shpallura në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimi i dhënë në institucionet e tilla të jetë në përputhje me normat minimale që mund të jenë caktuar nga shteti.

## **Neni 14**

Çdo shtet palë i këtij Pakti i cili, në çastin kur është bërë palë, nuk ka mundur të sigurojë në territorin e vet metropolit ose në territoret e tjera nën juridiksionin e tij arsimin

fillor të detyrueshëm dhe falas, zotohet që të vendosë dhe të miratojë brenda dy viteve, një plan të hollësishëm veprimi për zbatimin progresiv brenda një numri të arsyeshëm vitesh të përcaktuara në këtë plan, për zbatimin e plotë të parimit të arsimit fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë.

## **Neni 15**

1. Shtetet palë të këtij Pakti i njohin secilit të drejtën:

(a) E pjesëmarrjes në jetën kulturore;

(b) E gëzimit të përfitimeve nga progresi shkencor dhe nga aplikimet e tij;

(c) E përfitimit nga mbrojtja e interesave morale e materiale që rezultojnë nga çdo prodhim shkencor, letrar ose artistik autor i të cilit është ai vetë,

2. Masat të cilat shtetet palë të këtij Pakti do t'i marrin për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte duhet të përfshijnë ato që janë të nevojshme për ruajtjen, zhvillimin dhe përhapjen e shkencës dhe të kulturës.

3. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e domosdoshme për kërkimin shkencor dhe për veprimtarinë krijuese.

4. Shtetet palë të këtij Pakti njohin përfitimet që duhet të rrjedhin nga inkurajimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit dhe i kontakteve ndërkombëtare në fushën e shkencës dhe të kulturës.

## **PJESA E KATËRT**

### **Neni 16**

1. Shtetet palë të këtij Pakti, në përputhje me dispozitat e kësaj pjese të Paktit, zotohen të paraqesin raporte për masat që ato do t'i kenë marrë dhe për përparimin e arritur në sigurimin e respektimit të të drejtave të njohura në këtë Pakt.

1. (a) Të gjitha raportet duhet t'i paraqiten Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili i dorëzon kopjet Këshillit Ekonomik e Shoqëror, për shqyrtim, në përputhje me dispozitat e këtij Pakti.

(b) Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara u dorëzon gjithashtu organizatave të specializuara kopje të raporteve, ose të pjesëve përkatëse të raporteve që janë me interes, të dërguara nga shtetet palë të këtij Pakti që janë gjithashtu anëtare të këtyre organizatave të specializuara, për aq sa këto raporte, ose pjesë të



raporteve, kanë të bëjnë me problemet që hyjnë në kompetencën e këtyre organizatave sipas akteve të tyre kushtetuese.

### **Neni 17**

1. Shtetet palë të këtij Pakti i paraqesin raportet e tyre në faza, në përputhje me një program që do ta përcaktojë Këshilli Ekonomik e Shoqëror brenda një viti, duke filluar nga data e hyrjes së këtij Pakti në fuqi, pas konsultimeve me shtetet palë dhe me organizatat e specializuara të interesuara.

2. Raportet mund t'i tregojnë faktorët dhe vështirësitë që ndikojnë në shkallën e përmbushjes së detyrimeve sipas këtij Pakti.

3. Në rastin kur informacionet përkatëse për këtë çështje i janë dërguar paraprakisht Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose ndonjë organizate të specializuar nga një shtet palë i këtij Pakti, atëherë nuk do të ketë nevojë për dhënien e sërishme të këtyre informacioneve dhe do të mjaftojë një referencë e saktë në këto njoftime.

### **Neni 18**

Në bazë të përgjegjësisë së tij sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara në fushën e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, Këshilli Ekonomik e Shoqëror mund të përfundojë marrëveshje me organizatat e specializuara, më qëllim që këto të paraqesin raporte lidhur me përparimin e arritur përsa i përket respektimit të dispozitave të këtij Pakti që bëjnë pjesë në kuadër të veprimtarive të tyre. Këto raporte mund të përfshijnë hollësi të vendimeve dhe të rekomandimeve lidhur me zbatimin e miratuar nga organet e tyre kompetente.

### **Neni 19**

Këshilli Ekonomik e Shoqëror mund t'ia dërgojë Komisionit të të Drejtave të Njeriut, për studim dhe rekomandim të përgjithshëm ose për informacion, po qe se ka vend, raportet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut të cilat i paraqesin shtetet në përputhje me nenet 16 e 17 dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut të cilat i paraqesin organizatat e specializuara në përputhje me nenin 18.

### **Neni 20**

Shtetet palë të këtij Pakti dhe organizatat e specializuara të interesuara mund t'i paraqesin Këshillit Ekonomik e Shoqëror komente për çdo rekomandim të përgjithshëm në bazë të nenit 19 ose për çdo përmendje të një rekomandimi të përgjithshëm të tillë në

cilindo raport të Komisionit të të Drejtave të Njeriut ose në cilindo dokument të përmendur në këtë raport.

## **Neni 21**

Këshilli Ekonomik e Shoqëror mund t'i paraqesë Asamblesë së Përgjithshme raporte të herëpashershme me rekomandime të përgjithshme dhe një përmbledhje të informacioneve të marra nga shtetet palë të këtij Pakti dhe nga organizatat e specializuara për masat e marra dhe përparimin e bërë në arritjen e respektimit të përgjithshëm të të drejtave të njohura në këtë Pakt.

## **Neni 22**

Këshilli Ekonomik e Shoqëror mund t'u parashtrojë organeve të tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, organeve të tyre ndihmëse dhe organizatave të specializuara të interesuara që merren me dhënien e një ndihme teknike, çdo çështje që ngrihet në raportet e përmendura në këtë pjesë të Paktit dhe që mund t'i ndihmojë këta organizma që të vendosin, secili brenda fushës së kompetencës së vet, për këshillueshmërinë e masave ndërkombëtare për të kontribuar në zbatimin efektiv dhe shkallëzor të këtij Pakti.

## **Nenin 23**

Shtetet palë të këtij Pakti pajtohen se masat e veprimit ndërkombëtar për realizimin e të drejtave të njohura në këtë Pakt, përfshijnë metodat e tilla, siç janë përfundimi i marrëveshjeve, miratimi i rekomandimeve, dhënia e ndihmës teknike dhe mbajtja e mbledhjeve rajonale dhe e mbledhjeve teknike me qëllim konsultimi dhe studimi të organizuara në bashkëpunim me qeveritë e organizuara.

## **Neni 24**

Asgjë në këtë Pakt nuk duhet të interpretohet asisoj sikur cenon dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të statuteve të organizatave të specializuara që përkufizojnë përgjegjësitë përkatëse të organeve të ndryshme të Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të specializuara përsa u përket çështjeve të trajtuara në këtë Pakt.

## **Neni 25**

Asgjë në këtë Pakt nuk duhet të interpretohet asisoj sikur cenon të drejtën e lindur të të gjithë popujve për t'i përfituar dhe shfrytëzuar plotësisht dhe lirisht pasuritë dhe burimet e tyre natyrore.

## **PJESA E PESTË**

### **Neni 26**

1. Ky Pakt është i hapur për nënshkrimin e çdo shteti anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose anëtar i çfarëdo organizate të specializuar të tij, të çdo shteti palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë si dhe të çdo shteti tjetër të ftuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për t'u bërë palë e këtij Pakti.

2. Ky Pakt i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

3. Ky Pakt do të jetë i hapur për aderimin e çdo shteti të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Aderimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara i informon të gjitha shtetet të cilat kanë nënshkruar këtë Pakt ose kanë aderuar në të për depozitimimin e çdo instrumenti të ratifikimit ose të aderimit.

### **Neni 27**

1. Ky Pakt do të hyjë në fuqi tre muaj pas ditës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të tridhjetepetë të ratifikimit ose të aderimit.

2. Për secilin prej shteteve që do të ratifikojnë këtë Pakt ose do të aderojnë në të, pas depozitimit të instrumentit të tridhjetepetë të ratifikimit ose të aderimit, ky Pakt do të hyjë në fuqi tre muaj pas ditës së depozitimit, nga ky shtet, të instrumentit të tij të ratifikimit ose të aderimit.

### **Neni 28**

Dispozitat e këtij Pakti janë të zbatueshme, pa asnjë kufizim ose përjashtim, për të gjitha njësitë përbërëse të shteteve federative.

### **Neni 29**

1. Çdo shtet palë i këtij Pakti mund të propozojë një amendament dhe të depozitojë tekstin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua transmeton atëherë çdo amendament të propozuar shteteve palë të këtij

Pakti duke u kërkuar të deklarohen nëse dëshirojnë të thirret një konferencë e shteteve palë për të shqyrtuar këto propozime dhe për të votuar për to. Në qoftë se të paktën një e treta e shteteve deklarohen për thirrjen e konferencës, Sekretari i Përgjithshëm thërret Konferencën nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e shteteve të pranishme dhe votuese në Konferencë i shtrohet për miratim Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

2. Këto amendamente hyjnë në fuqi pasi t'i ketë miratuar Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe t'i ketë pranuar, në përputhje me rregullat e tyre kushtetuese përkatëse, një shumicë e dy të tretave të shteteve palë të këtij Pakti.

3. Kur këto amendamente hyjnë në fuqi, ato bëhen të detyrueshme për shtetet palë që i kanë pranuar, ndërsa shtetet e tjera mbeten të lidhura me dispozitat e këtij Pakti dhe me çdo amendament të mëparshëm që është pranuar prej tyre.

### **Neni 30**

Pavarësisht nga njoftimet e parashikuara në nenin 26, paragrafin 5, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'i informojë të gjitha shtetet që përmenden në paragrafin 1 të nenit të sipërpërmendur:

(a) Lidhur me nënshkrimet që janë dhënë në këtë Pakt dhe me instrumentet e ratifikimit dhe të aderimit të depozituara në përputhje me nenin 26.

(b) Lidhur me ditën në të cilën ky Pakt do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 27 dhe me ditën në të cilën do të hyjnë në fuqi amendamentet e parashikuara në nenin 29.

### **Neni 31**

1. Ky Pakt, tekstet e të cilit në gjuhët kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njësoj autentike, do të depozitohet në arkivat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'ua dorëzojë një kopje të vërtetuar të këtij Pakti të gjitha shteteve të përmendura në nenin 26.